

Arrestohet një i dyshuar për armëmbajtje pa leje në Letnicë të Vitisë



Raporton: Genta PAJAZITI
 Gusht 27, 2020

Viti – Një person është arrestuar në orët e vona të së martës, në fshatin Letnicë të Komunës së Vitisë, për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale të armëmbajtjes pa leje.

Një gjë e tillë u bë e ditur përmes raportit 24 orësh të Policisë së Kosovës.

“Fsh. Letnice, Viti 25.08.2020 – 23:35. Është arrestuar i dyshuari mashkull kosovar pasi që gjatë kontrollit tek i njëjti është gjetur dhe konfiskuar arma TT me një karikator me katër fishek të kalibrit 7.62 mm”, thuhet në njoftim të Policisë.

Sipas njoftimit të Policisë së Kosovës, i dyshuari pas intervistimit, me urdhër të prokurorit, është liruar në procedurë të rregullt. /BetimipërDrejtësi


EMISIONI I FUNDIT



Qasja e Komisionit për Legjislacion për sundimin e ligjit

13 Qershor, 2020

EMISIONET E FUNDIT



Prioritetet e Ministrisë së Drejtësisë

6 Qershor, 2020



Kush e mbron privatësinë në Kosovë?

30 Maj, 2020



Programi për kompensimin e viktimave të krimit

23 Maj, 2020

[shiko të gjitha ⇨](#)

VEGZA DIREKTE

Insituti i Kosovës për Drejtësi
 Radio Televizioni i Kosovës

BASHKOHU ME NE NË:



Copyright © Betimi për Drejtësi. Asnjë material apo informacion i publikuar në këtë faqe nuk mund të kopjohet, të shtypet, ose të përdoret në çfarëdo forme tjetër për çfarëdo qëllimi pa respektuar të drejtat e autorit. Kushdo që dëshiron t'i referohet emisioneve apo shkrimeve të publikuara në portalin “Betimi për Drejtësi”, duhet të marrë paraprakisht lejen nga autori. Deri në 30 % të shkrimit mund të merret, vetëm nëse artikulli përmban referencën e saktë të portalit “Betimi për Drejtësi”. Emisionet dhe shkrimet mund të ripublikohen në marrëveshje me redaksinë. Çdo shkelje në drejtim të drejtave të autorit do të ndiqet përmes rrugës ligjore.